



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.511/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj, kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë:

#### VE N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesat A.nr.511/2025, Anr.512/2025, Anr.513/2025, Anr.514/2025, të datës 10.02.2025, të parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës .

#### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.511/2025, Anr.512/2025, Anr.513/2025, Anr.514/2025, më datë 10.02.2025.

Në ankesën A.nr 511/2025, pretendohet se LDK Dega në Prishtinë, ka vërejtur se Këshilltari i Jashtëm Politik i Kryeministrit për Marrëdhëniet me Maqedoninë e Veriut — Bekim (Qoku), e ka shkelur nenin 37 paragrafi 1. nenparagrafi 1.2 i LZP-se dhe neni 8 paragrafi 1, nenparagrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e postimit dhe thirrjeve për votim nga rrjeti i tij social Facebook dhe me rastin e shpërndarjes së 3 postimeve tjera të mbështetësve Arben Taravari, Izet Mexhiti cihe Zeqirja Ibrahim. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur provën që dëshmon shkeljen e tillë të bërë në ditën e zgjedhjeve. Duke i propozuar PZAP që të i shqiptoj masë sanksionuese subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV.

Në ankesën Anr.512/2025 pretendohet se LDK Dega ne Prishtine, ka vërejtur se kandidati për deputet Dimal Basha, e ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nenparagrafi I. 11 të LZP-se, me rastin e postimit te tij ne rrjetin social Facebook per gjuhen urrejtëse, nxitëse, provokuese dhe të ndytur qe ka përdorur. Parashtruesi i ankesës si provë kanë bashkangjitur provën që dëshmon për shkeljet e tilla të bëra në ditën e zgjedhjeve. Duke i propozuar PZAP që të i shqiptoj masë sanksionuese subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV.

Në ankesën Anr.513/2025 pretendohet se LDK Dega ne Prishtine ka vërejtur dje me date 9 shkurt, se mbështetësit e subjektit politik LVV, e kane shkelur nenin 34 paragrafi 1, nenparagrafi 1.11 te LZP-se, me rastin e fjalimeve tyre te transmetuara ne rrjetin social facebook me c'rast kane përdorur gjuhe urrejtëse, nxitëse e provokuese. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy CD për shkeljet e kryera nga këta mbështetës. Duke i propozuar PZAP që të i shqiptoj masë sanksionuese subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV.

Në ankesën Anr.514/2025 pretendohet se LDK Dega ne Prishtine, ka vërejtur se kandidati per deputet Albin Kurti, e ka shkelur nenin 34 paragrafi 1, nenparagrafi 1.11 te LZP-se, me rastin e fjalimit te tij ne Sheshin "Skenderbeu" ne Prishtine, me c'rast ka përdorur gjuhe urrejtëse, nxitëse e provokuese. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur CD si provë për shkeljen e bërë. Duke i propozuar PZAP që të i shqiptoj masë sanksionuese subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje LVV.

PZAP iu drejtua me kërkesa për përgjigje subjektit politik LVV, lidhur me ankesat Anr.511/2025, Anr.512/2025, Anr.513/2025 dhe 514/2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.511/2025 theksohet se Z. Qoku është deputet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe i cili nuk bën pjesë në strukturat e LVV në Kosovë, i cili ka shfrytëzuar të drejtën demokratike për të bërë thirrje për të votuar. Fakti që z. Qoku është deputet në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe i cili nuk bën pjesë në strukturat e LVV në Kosovë, mund të vërehet më një shikim të thjeshtë në Llogarinë e saj në rrjetin social Facebook. Parashtruesi i përgjigjes në ankesë si ka bashkangjitur si provë: Profili në FB i z. Qoku: <https://www.facebook.com/nita.blacaku>

Lidhur me ankesën Anr.512/2025 subjekti politik LVV Si Lëvizje VETËVENDOSJE! kanë vlerësuar se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se në ankesë dhe në fotografinë e bashkangjitur ankesës si provë nuk gjendet asnjë fjalë që konsiderohet gjuhë urrejtëse, nxitëse apo e ndyer dhe konsiderojmë që ankesa nuk përmban elemente të cilat do ta ndërlihdnin shkeljen e pretenduar si shkelje e Cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Për me tepër, subjekti ankues pretendon që përmes këtij postimi nga kandidati për deputet Dimal Basha është bërë Shkelje e nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së por kjo dispozitë sanksionon veprimet e subjekteve politike/kandidatëve gjatë periudhës së fushatës e cila ka përfunduar më datë 8 shkurt 2025. Postimi i kandidatit Dimal Basha është bërë më datë 9 Shkurt 2025, në orën 11:56 PM (23:56) atëherë kur ka përfunduar edhe procesi zgjedhor.

Në përgjigjen në ankesën Anr.513/2025 theksohet Si Lëvizje VETËVENDOSJE! kanë vlerësuar se, ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme. Kjo për faktin se në ankesë dhe në videot e bashkangjitur ankesës ( prova 1 dhe prova 2) nuk ka asnjë të dhënë për identitetin e personave të paraqitur në video, nuk ka të dhëna që dëshmojnë që të njëjtit janë mbështetës të subjektit politik LVV, nuk ka asnjë të dhënë për verifikimin e kohës se kur janë bërë xhirimet dhe konsiderojmë që ankesa nuk përmban elemente të cilat do ta ndërlihdnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Subjekti ankues pretendon që përmes këtyre postimeve/video është bërë shkelje e nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së por kjo dispozitë sanksionon veprimet e subjekteve politike/mbështetësve gjatë periudhës së fushatës e cila ka përfunduar më datë 8 shkurt 2025.

Në përgjigjen për ankesën Anr.514/2025 theksohet se pretendimet e tilla, janë të paqëndrueshme dhe të palejuara për faktin se deklaratat e tilla janë jashtë domenit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore, mbi të cilën bazë, pretendohet nga parashtruesi.

Deklaratat e tilla janë bërë së paku 5 orë pas përfundimit të heshtjes zgjedhore dhe pas mbylljes së qendrave të votimit, dhe pretendimet e tilla nuk kanë bazë ligjore.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.511/2025, Anr.512/2025, Anr.513/2025, Anr.514/2025 të datës 10.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët Anr.511/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekte politike LDK kundër subjektit politik LVV për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

### **Ankesat janë të pabazuara**

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesat e cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se mbështetësit dhe kandidatët e subjektit politik LVV kane thyer rregullat zgjedhore ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të pa bazuara.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se subjekti politik LVV ka bërë veprime të ndaluara gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete. Paneli duke analizuar ankesën Anr.511/2025 vërtetoi se në raport me shkeljet e pretenduara nga mbështetësit nga Maqedonia e Veriut, paneli vlerësoi se kjo nuk mund të konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në vendin tonë kjo pasi që qytetarët e një vendi tjetër mund të jenë mbështetës të një subjekti të vendit tonë por të njëjtit nuk kanë të drejtë vote në vendin tonë dhe rrjedhimisht nuk mund të konsiderohen si mbështetës në kuptim të LZP-së.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.512/2025 vërtetoi se, shkelja e pretenduar sipas kësaj ankesë nuk mund të konsiderohet shkelje e rregullave në ditën e zgjedhjeve pasi që nga shikimi i postimit në rrjetin social Facebook të kandidatit Dimal Basha rezultoi se i njëjti postim është bërë pas mbylljes së Qendrave të Votimeve (Datë 09 Shkurt 2025, në ora 11:56 PM ose 23:56).

Paneli duke analizuar ankesën Anr.513 vërtetoi se, postimet e njëjta nga mbështetësit e subjektit politik LVV nuk mund të identifikohet qartë në cilën ditë janë bërë.

Paneli duke analizuar ankesën Anr.514 vërtetoi se nga kandidati për deputet dhe kryeministër z.Albin Kurti nuk është bërë shkelje e rregullave zgjedhore ditën e votimit pasi që i njëjti këto deklaramë nuk i ka bërë në kohë të fushatës por janë bërë pas mbylljes së Qendrave të Votimit. Neni 34 i referohet veprimeve të ndaluara gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa me nenin 3 të Ligjit për Zgjedhje përkatësisht pikës 1.29, qartë është përcaktuar se çka konsiderohet periudhë e fushatës, që rezultoi se fushata përfundon më hapjen e Qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve. Në rastin konkret deklaramet e tij janë bërë pas përfundimit të procesit zgjedhor që është një video që kanë mundur ta shohin të gjithë, e njëjta është bërë me rastin e përfundimit të procesit zgjedhor në tubimin e LVV-së për të shënuar fitoren.

Kështu që PZAP-i pretendimet ankimore të cituara si më lartë i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitur ankesave nuk vërtetohet se nga subjekti politik LVV është shkelur neni 37 paragrafi 1.2 i LZP *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohej secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2 Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e subjektit politik në fjalë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesave, në ankesat e tij ka bashkangjitur disa foto/video, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohen shkeljet e pretenduara, e që sipas vlerësimit të Panelit nuk ka shkelje të rregullave zgjedhore në ditën e votimit.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesat janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesit e ankesave nuk kanë arritur që të vërtetojnë pretendimet e theksuara si më lartë.

Prandaj, nga sa u tha më lartë ankesat vlerësohen si të pabazuara duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1, të LZP-së, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.511/2021 më datën 12.02.2025.

Kryesuese e Panelit  
Hidajete Gashi Alaj



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.